



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

01Nr. 60/01-10511/22
Kaçanik, 22.04.2022

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **IV (katërt)** e Rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa (Legjislatura e VII e Kuvendit të Komunës), mbajtur me 22 prill 2022. Mbledhja u mbajt në katin e tretë të objektit të administratës komunale, në sallën e KK, me fillim pune në ora 11:00.

Pjesëmarrës në mbledhje nga Komiteti për Politikë dhe Financa- KPF ishin të anëtarët: Kemal Murseli, Kadri Krivenjeva, Fitore Vishi, Agim Mani, Kadrije Lika-Troni, Ardita Rrahmani dhe Rabije Sallahi.

Nga Ekzekutivi i Komunës në mbledhje morën pjesë; Nënkryetari i Komunës-Sabedin Vishi, Qamil Stagova-drejtor i DUKMM, Bahri Selimi- drejtor i DBF, ndërkaq nga zyrtarët, Arbnora Kuka-Asistente e Kryesuesit të Kuvendit.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit.

Procesmbajtës: Makfire Malsiu, Zyrtare për punë të KK.

Fillimisht Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Murseli, i përshëndeti pjesëmarrësit e kësaj mbledhje, konstatoj kuorumin, kushte pune për tu mbajtur mbledhja ka, andaj e hapi mbledhjen e IV (katërt) të rregullt të KPF-a për vitin 2022, data 22 prill, me këtë:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF;
2. Raporti Financiar për periudhën, Janar-Mars 2022;
3. Propozim Vendim për transferin e mjeteve nga rezerva komunale sipas buxhetit të vitit 2022;
4. Propozim Vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik për këmbim të pronës komunale me pronën private ZK Bob, parcela me nr. 175-0;
5. Propozim Vendimi Paraprak për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, PK 00824-11 ZK Strazhë, me kulturë Tokë Pyjore- Mal i Klasës 4, me sipërfaqe 637 m², pronë e Kadri (Faik) Lalinovci nga Ferizaj;
6. **Propozim Vendimi Paraprak për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, PK 00443-4 ZK Duraj, me kulturë Pyjore-Mal i Klasës 1, me sipërfaqe 5455m², pronë e Tefik (Metush) Zenuni nga Duraj (Hiqet);**
7. Propozim Vendimi për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, PK 01402-1 ZK Soponicë, me kulturë Bujqësore Arë e Klasës së 5, me sipërfaqen 3917m², pronë e Ekrem (Ramadan) Hyseni nga Ferizaj, nën qiramarrje 99 vjet;
8. Propozim Vendimi për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, PK 00311-0 ZK Ivajë, me kulturë Bujqësore Livadh i Klasës së 6, në sipërfaqen 300m², pronë e Samedin (Vehbi) Rexha nga Kaçaniku;
9. Propozim Vendimi për emërimin e komisionit përzgjedhës për drejtor të institucioneve arsimore;

10. Propozim Vendimi për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore PK 01123-6 ZK Kaçanik i Vjetër, me kulturë bujqësore Arë e Klasës 6, me sipërfaqe 600 m², pronë e KBI;
11. Propozim Vendimi për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore PK 0001952-0 ZK Kaçanik, me kulturë bujqësore Arë e Klasës 6, me sipërfaqe 600 m², pronë e KBI; dhe
12. Propozim Vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik për këmbim të pronës komunale me pronën private ZK Begracë, 17 parcela të evidentuara në emër të N.P.P.T.T.SH. ALK-OIL me nr. të biznesit 70052105.

Në vazhdim Kryesuesi i Kuvendit lidhur me rendin e punës e hapi diskutimin:

z. Qamil Stagova- drejtor i DUKMM: Kërkoj që pika e 6 Propozim Vendimi Paraprak për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, PK 00443-4 ZK Duraj, me kulturë Pyjore-Mal i Klasës 1, me sipërfaqe 5455m², pronë e Tefik (Metush) Zenuni nga Duraj, të hiqet nga rendi i punës, për shkak se lënda nuk është sa duhet. e kompletuar.

Kryesuesi i Kuvendit: Atëherë e shtroj rendin e punës në votim pa pikën 6 dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF e,

APROVON

Rendin e punës në përbërje prej 11 pikëve (renditja nga 1-5 dhe 7-12).

U kalua në shqyrtimin e pikave sipas renditjes së aprovuar:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF;

Kryesuesi i Kuvendit: Materialin e keni marrë, a ka kush ndonjë vërejtje në procesverbal?

Kadrije Lika-Troni: Te pika e 10, f. 11, të diskutimi i im, ku thuhet shkollën e Kovaçecit e ka ndërtuar ministria, pasuesi “ministria” hiqet, shtohet pasuesi “komuna”.

Agim Mani: Të pika e 11, unë kam kërkuar nga drejtori i DUKMM, Qamil Stagova sqarim për pronat të cilat këmben, por sqarimi i drejtorit nuk është shënuar në procesverbal. Sqarimi i drejtorit ishte se kemi të bëjmë me këmbim të pronave, ndërkaq kryetari në mbledhje të KK në pyetjen e cila iu është bërë nga 1 anëtar i KK, ka thënë se nuk është këmbim.

Kryesuesi i Kuvendit: Procesverbalin e mbledhjes së kaluar të KPF me këto vërejtje e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF e

APROVON

Procesverbalin e mbledhjes së III-të (tretë) të rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF) të datës 24.03.2022 / Lënda: 01Nr. 60/03-7800/22.

Vërejtjet e dhëna në procesverbal do të korrigjohen, procesverbali do të publikohet i korrigjuar.

2. Raporti Financiar për periudhën, Janar-Mars 2022;

Kryesuesi i Kuvendit: Materialin e keni marrë, drejtori është prezentë në mbledhje, Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

z. Agim Mani: Kërkoj t ‘na e elaboron drejtori raportin financiar.

z. Bahri Selimi: Raporti është paraqitur njëjtë si në vitet tjera. Janë 13 nën programe buxhetore që marrin pjesë në shpenzimin e buxhetit. Buxheti i aprovuar është 9,193,163, ndërkaq janë shpenzuar në këtë 3 muaj 1 milion e 400 mijë, apo 15.66%. Buxheti i vitit 2022 për 8.22% ka pësuar rënie në krahasim me buxhetin e vitit të kaluar të njëjtës periudhë, kjo për faktin se kemi pasur obligime me pak në vitin 2021 nga viti 2020. Të HVK janë 23.54% realizimi, nga TP realizohen diku 70% e buxhetit, por ka ndryshuar një rregull e qeverisë se nuk kemi të drejtë ne me kushtëzuar tatimin në pronë, 162.323 € është inkasim i mirë dhe i tejkaluar. Drejtori në vazhdim i dha me shifra shpenzimet për paga dhe mëditje, 23.63%, mallra dhe shërbime, 16.26%, 5.92% shpenzimet komunale, 8.82% subvencione dhe transfere, shpenzimet kapitale 0.09% është paguar vetëm një borxh 1924 €, nuk ka pasur nevojë për me bashkëngjitur tabelë. Shpenzimet janë paraqitur në tabela. Drejtori i dha me shifra sesi janë shpenzuar mjetet nga subvencionet dhe transferet nga secili program shpenzues buxhetor, paraqitur si në tabelat e raportit financiar.

znj. Ardita Rrahmani: Të Subvencionet dhe transferet të drejtorisë e Arsimit, mjetet të cilat janë ndarë për pagesën e transportit të nxënësve, a është shuma e njëjtë si në vitin e kaluar, apo janë rritur shpenzimet, pasi që ka pasur ngritje të çmimit të buletave ?

z. Bahri Selimi: Marrëveshjet nuk janë ndryshuar me transportuesit, këtu mund të ketë ndonjë ndryshim për shkak se mund të bien numri i nxënësve, apo të ngjashme, se mund të përjashtohet nga transporti ndonjë nxënës e kështu me radhë, por marrëveshjet janë të njëjta.

z. Agim Mani: Të kategoria e shpenzimeve të pagat dhe mëditjet, në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, në periudhën raportuese të vitit 2022 janë shpenzuar me pak mjete në këtë kategori. Çka është në pyetje që është ky dallim ?

z. Bahri Selimi: Analizë nuk kam bërë, nganjëherë varion punë-zënia, 82793€ janë me pak sivjet apo 6.22%. Unë mundem me shikuar për me sjellë për KK apo të dërgoj me email sqarimin. Ndryshimet ne i dërgojmë muaj për muaj, ose ka pasur pagesa të pagave jubilarë apo ndonjë ndryshim tjetër.

Kryesuesi i Kuvendit: Viti 2021 ka qenë vit pandemie, ka pasur të angazhuar edhe staf shtesë si në arsim ashtu edhe në shëndetësi, besoj kjo mund të jetë arsyeja e ndryshimeve. Diskutime të tjera nuk ka, atëherë a jeni që ky raport t'i shkoj KK? Njëzëri u pajtuan të gjithë. Në sajë të kësaj del konstatimi së, **KPF diskutoj Raportin Financiar për periudhën, Janar-Mars 2022, të njëjtin ia kalon Kuvendit të Komunës në procedurë shqyrtimi.**

3. Propozim Vendim për transferin e mjeteve nga rezerva komunale sipas buxhetit të vitit 2022;

Kryesuesi i Kuvendit: Paraprakisht drejtori kërkoj me sqaruar se ka pasur pak ndryshime drafti nga ai i dërguar me herët. Fjalën e ka drejtori i DBF, Bahri Selimi:

z. Bahri Selimi: Pas muajit mars gjithmonë të gjitha komunat bëjnë transfer të mjeteve varësisht si e kanë buxhetin, por jo me ngritur apo zvogëluar buxhetin, bëhen lëvizje të brendshme. Kur e kemi bërë buxhetin e vitit të kaluar, MEF, disa projekte na i ka kaluar në rezervë për me i plotësuar disa kushte teknike në emërtime me i kthyer prapë aty ku kanë qenë. Kur e dërguam propozim vendimin në MEF, ata kërkuar me ndryshuar të emërtimi 1.3 dhe 2.3 se nuk i kanë pranuar projektet me emërtimet: 1. Renovimin e objekteve shumëkatëshe banesore të shtëpia e kulturës dhe 2. Hartimi i projekteve, sepse Udhëzimi administrativ ka ndryshuar, tani këto financohen nga mallrat dhe shërbimet. Atëherë jemi detyruar që mjetet me i shpërndarë të projektet të cilat i kemi aktualisht: Rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve lokale; Ndërtim i shtretërve të lumenjve dhe

përroskave, shuma 30.000€ Të pika 2.3 është një ndryshim i vogël, hiqet projekti, Renovimi i objekteve banesore të shtëpia e kulturës dhe hartimi i projekteve, dhe emërtohet projekti: 1. Rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve në pjesën urbane dhe rurale në Kaçanik; dhe projekti, 2. Ndërtimi i kanalizimit fekal dhe atmosferik, shuma 20.000€. këto projekte që po shkojnë mjete i kemi të aprovuara, janë në listë të prioritetet.

znj. Ardita Rrahmani: Çka bëhet me projektet të cilat na i keni dërguar me propozim vendimin e parë, projektet: Renovimi i objekteve shumëkatëshe banesore të shtëpia e kulturës; dhe Hartimi i projekteve ?

z. Bahri Selimi: Ato dy projekte hiqen.

Kryesuesi i Kuvendit: Projektet: Renovimi i objekteve shumëkatëshe banesore të shtëpia e kulturës dhe Hartimi i projekteve kanë qenë të parapara në propozim vendimin e parë. MEF ka thënë që, këto projekte duhet me u financuar nga mallrat dhe shërbimet, e jo nga investimet kapitale dhe janë detyruar ekzekutivi me i kthyer në projektet: Rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve në pjesën urbane dhe rurale; Ndërtimi i kanalizimit fekal dhe atmosferik. Për mbledhje të KK iu vjen Propozim Vendimi i ndryshuar. Diskutime të tjera nuk ka, atëherë e shtroj në votim për aprovim Propozim Vendimin e kësaj pike, i njëjti u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF e,

Aprovoj

Propozim Vendimin për transferin e mjeteve nga rezerva komunale sipas buxhetit të vitit 2022. Të njëjtin ia

Rekomandon

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

znj. Ardita Rrahmani: Meqenëse kjo pikë kaloj, ndoshta do ishte me mirë fillimisht me pasur përgjigje prej ministrisë, pastaj me na ardhur materiali neve.

Kryesuesi i Kuvendit: Këto shkojnë krahas shpërndarjes së materialeve, njëkohësisht i dërgohen edhe ministrisë edhe anëtarëve të KK. Kalojmë në pikën vijuese:

4. Propozim Vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik për këmbim të pronës komunale me pronën private ZK Bob, parcela me nr. 175-0;

Materialin e keni marrë, drejtori është prezentë në mbledhje, nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

znj. Kadrije Lika-Troni: Kërkoj t 'na elaboron drejtori i DUKMM me në detaje Propozim Vendimin.

z. Qamil Stagova: Kjo parcelë është në afërsi të SHMP, sipërfaqja 177m2 të parcelës i kalojnë komunës, për një zgjidhje me të mirë për zgjerimin e rrugës. Prona është afër rrugës dhe i epët pronë pronarit të kësaj prone, në dy prona aty afër në këmbim me pronën e tij.

Kryesuesi i Kuvendit: Prona e cila po kërkohet me u shpallë interes, është përgjatë vijës rrugore, që është e nevojshme për zgjerimin e rrugës, ndërkaq i epën 2 parcela që i ofrohen në këmbim. Është mirë që po pranon pronari me këmbyer pronën, me dhënë pronë afër rrugës dhe me marrë diku tjetër.

z. Agim Mani: Pyetje për drejtorin, kjo prerja këtu e paraqitur si në skemë, pjesa përtej një shtëpie, a është pronë komunale ?

z. Qamil Stagova: Për cilën pronë e keni fjalën, duke shkuar kah shkolla apo në anën tjetër ?

z. Agim Mani: Të pjesa ku janë 2 shtëpi të ndërtuara. Çështja është që nëse është e nevojshme me u rregulluar kjo çështje me një procedurë e mos me u marrë më me këtë punë. E tha edhe kryesuesi, mirë që po dëgjojnë me bërë këmbime, me shqyrtuar mundësinë me u rregulluar edhe kjo pronë, se duhet me iu bërë zgjidhje pronarëve. Komuna duhet me kërkuar këtë këmbim se është me interes publik.

z. Qamil Stagova: Sqaroj për pronat të cilat këmbehen, të paraqitur si në skemë.

z. Sabedin Vishi: Lidhur me kërkesën e Agimit për me u rregulluar edhe pjesa tjetër me një procedurë, çështja është se pronari i asaj prone nuk ka kërkuar me këmbyer atë pronë.

Kryesuesi i kuvendit: Komuna kur ka interes publik, merr veprime, por çështja është se ne nuk kemi nevojë me i dhënë tokë atij veç se e ka ndërtuar shtëpinë në rrugë. Ai në një farë forme është uzurpator i rrugës. Aty nuk mundesh me hyrë në marrëveshje për këmbim me të, për me marrë pronën tënde, kjo nuk ka logjikë, por duhet shikuar modalitete për me krijuar hapësira me bërë zgjidhje. Diskutime të tjera nuk ka, atëherë e shtroj në votim për aprovim Propozim Vendimin e kësaj pike, i njëjti u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF e,

Aprovoj

Propozim Vendimin për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik për këmbim të pronës komunale me pronën private ZK Bob, parcela me nr. 175-0. Të njëjtin ia

Rekomandon

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

5. Propozim Vendimi Paraprak për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, PK 00824-11 ZK Strazhë, me kulturë Tokë Pyjore- Mal i Klasës 4, me sipërfaqe 637 m², pronë e Kadri (Faik) Lalinovci nga Ferizaj;

Kryesuesi i Kuvendit: Ky është Vendim Paraprak që ka të bëjë me ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore të klasës së 4. Lënda duhet t'i shkoj edhe ministrisë, në mënyrë që pas miratimit të ministrisë t'i procedohet edhe njëherë KK për vendimin përfundimtar. Nëse ka kush diçka, e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë Propozim Vendimin e kësaj pike e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF e,

Aprovoj

Propozim Vendimi Paraprak për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, PK 00824-11 ZK Strazhë, me kulturë Tokë Pyjore- Mal i Klasës 4, me sipërfaqe 637 m², pronë e Kadri (Faik) Lalinovci nga Ferizaj. Të njëjtin ia

Rekomandon

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

Kryesuesi i Kuvendit: Pika 6 është hequr nga rendi i punës, atëherë kalojmë në pikën vijuese:

7. Propozim Vendimi për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, PK 01402-1 ZK Soponicë, me kulturë Bujqësore Arë e Klasës së 5, me sipërfaqen 3917m², pronë e Ekrem (Ramadan) Hyseni nga Ferizaj, nën qiramarrje 99 vjet;

Kryesuesi i Kuvendit: Unë po ua bëjë me dije për një vendim të vitit 2009, me të cilën iu është bartur nga KK, kompetenca KPF për ndërrimin e destinimit të sipërfaqeve të vogla të klasës 5 dhe klasës së 6. Unë kam kërkuar me u ndryshuar vendimi dhe me iu kthyer e drejta KK për me i vendosur këto çështje, për shkak së vendimi për ndërrim destinimi është për sipërfaqe të vogla,

ndërkaq ne si KPF po përballemi edhe me ndërrim destinimi të klasës 5 dhe 6 edhe të sipërfaqeve të mëdha, kështu që mos t'i kalojmë kompetencat tona si KPF, por t'ia kthejmë KK atë kompetencë, pasi që vendimet e KK shkojnë në vlerësim të ligjshmërisë, ndërkaq të KPF jo, kështu që mundemi me gabuar në këtë drejtim. Unë e kam hartuar Propozim Vendimin për KK, kështu që lë të del si propozim i KPF për shkak se tani mund të përballemi me sipërfaqe me të mëdha të ndërrimit të destinimit. Kur është marrë ai vendim, ka pasur arsye se toka ka qenë pothuajse bujqësore, ndërkaq nevojat për ndërtimin e shtëpive kanë qenë të mëdha, për mos me u ngarkua KK me këto çështje, ia ka bartur këtë kompetencë KPF-së. Andaj është mirë që atë kompetencë t'ia kthejmë kuvendit, kuvendi lë të vendosë, pastaj shqyrtohet ligjshmëria në MAPL se a është në rregull apo jo, dhe nuk kemi ndonjë farë përgjegjësie që na penalizon. Po ua bëj me dije këtë çështje, tani kemi kërkesën e Ekrem Hyseni për ndërrim destinimi sipërfaqe të mëdha e klasës së 5 dhe ia kemi adresuar KK.

Materialin e keni marrë, nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

z. Agim Mani: Mua me intereson të ky propozim vendim çështja e nën qiramarrjes. Nga e ka marrë këtë pronë, a e ka marrë nga komuna, apo e ka marrë me privatizim?

Kryesuesi i Kuvendit: Sqaroj së atë pronë Ekrem Hyseni e ka marrë me privatizim.

z. Agim Mani: Atëherë nëse është privatizuar kjo pronë, besoj se ka pasur projekte dhe synime tjera për çka është privatizuar. Sigurisht para privatizimit ka pasur ndonjë projekt ideor apo të detajuar për me marrë në shfrytëzim atë pronë.

z. Qamil Stagova: Këtu është rasti i privatizimit të tokave bujqësore. Prona është të Fusha e Pajtitimit në atë rrafshin ku e ka pasur deponinë kompania Bektel Enka. Atëherë janë shitur tokat bujqësore, nuk ka qenë fjala me dërguar ndonjë projekt, sikur ne që i japim në shfrytëzim tokat, atëherë janë dhënë në shfrytëzim jo vetëm tokat bujqësore, por janë privatizuar edhe tokat e kooperativës bujqësore. Komisioni ka dalë në vendngjarje dhe ka konstatuar se ajo tokë nuk ka më karakter bujqësor, për shkak së është përdorur si deponi e zhavorrit nga Bektel Enka. Për këtë arsye komisioni ka ardhur në përfundim se mundet me iu ndërruar destinimi i asaj prone.

z. Agim Mani: Unë nuk e di me çfarë të drejte komisioni mundet me konstatuar gjendjen e asaj prone vetëm me shikim. Neve po na duhet argumenti, sepse nëse vetëm del e shikon me sy dhe e vlerëson se nuk është tokë bujqësore, kjo nuk është e mjaftueshme, neve po na duhet argumenti. Cili është qëllimi që po ridestinohet kjo tokë bujqësore në tokë ndërtimore?

z. Qamil Stagova: Ai në bazë të saj qysh është paraqitur, aty ka me bërë parking të kamionëve, dhe një lokal të cilin kanë me shfrytëzuar shoferët e atyre kamionëve.

z. Agim Mani: Kjo po i bien që ne në këtë rast, në këtë formë po i dëmtojmë pronat bujqësore. Ne, në vend se t'i ruajmë tokat bujqësore, po i japim mundësinë me i ridestinuuar në toka ndërtimore. Ajo tokë është privatizuar si tokë bujqësore, ajo tokë nuk është privatizuar për me u ndërtuar, por është privatizuar me u zhvilluar toka bujqësore, me u punuar. Mirëpo, tani ai mundet me bërë gjithçka aty dhe me ridestinuuar atë pronë. Mua nuk mundet me më bind një komision që del në vendngjarje dhe e shikon me sy atë pronë dhe e vlerëson me iu ndërruar destinimi, sepse duhet një ekspertizë me e madhe, e jo vetëm me një shikim. Nuk mundemi me qenë bindes, vetëm se komisioni ka dalë në vendngjarje dhe e ka konstatuar me shikim, ndërrimin e destinimit të asaj toke bujqësore. Për atë unë kërkoja nëse ka ndonjë dëshmi tjetër- ekspertizë për vlerësim të ndërrimit të destinimit të asaj toke bujqësore.

z. Qamil Stagova: Ne kemi dal me Propozim Vendim në bazë të vlerësimit të komisionit, kuvendi është ai i cili vendosë.

Kryesuesi i Kuvendit: Ne nuk bëjmë ekspertiza. Është një komisioni formuar për këtë çështje, i cili i ka dhënë nënshkrimet në procesverbalin e hartuar. Është procesverbali i nënshkruar, komisioni është profesional. Procedura është: pala i bënë kërkesë drejtorisë, drejtorja e formon komisionin, komisioni e jep vlerësimin dhe ia dërgon drejtorisë, ndërkaq drejtorja e bënë propozimin për KPF dhe KK në bazë të vlerësimit të komisionit. Përgjegjësia në këtë rast me tepër i bien mbi komisionin, sepse komisioni është themeluar enkas për vlerësimin e gjendjes në terren. Ne nuk jemi ekspert për me shikuar gjendjen në terren, ne nuk jemi profesional me bërë vlerësimin, komisioni është profesional i fushës, i cili e vlerëson gjendjen në terren. Në momentin që komisioni e ka bërë vlerësimin në terren dhe ia ka propozuar drejtorisë për ndërrimin e destinimit të asaj toke, drejtorja e bënë propozim vendimin dhe e bien në KK, se komisioni nuk ka kompetencë me vendosur vet. Në KK dikush mundet me u pajtuar dikush jo, ndërkaq të ndërrimi i destinimit të tokës bujqësore, janë kushtet të cilat e karakterizojnë se cilave tokave mundën me iu ndërruar destinimi, cilave jo. Nëse i ke lexuar, p.sh. nëse ka ndërtime në afërsi, nëse ka nevojë për zhvillim, edhe këtu pikërisht kemi të bëjmë me një pronë e cila është ngjitur me zonën ekonomike të shpallur. Zona ekonomike e shpallur është nga Fusha e Pajtimit deri të Pishina Medi, KK e ka shpallë zonë ekonomike atë pjesë. Në momentin që e kemi shpallur zonë ekonomike atë pjesë, ku është logjika e kuptimi me ruajtje karakterin e tokës bujqësore në atë pjesë. Kjo është e para. E dyta, ne duhet me bërë zgjidhje sa me parë që është e mundur këtyre çështjeve, sepse jemi duke i zvarritur palët në trajtimin e ndërrimit të destinimit të tokës bujqësore, sepse ka lëndë që po shkojnë në ministri dhe iu vonohen me vjet, kështu që me Planin e ri zhvillimor komunal duhet propozohet që, toka e cila është skaj magjistrales, toka që është skaj rrugës kryesore, të futet në PZHK për zona ekonomike për zhvillim, edhe t'i iku më këtyre vendimeve. Me PZHK të trajtohen këto çështje, pala bënë kërkesë dhe pagesën për ndërrim destinimi dhe më nuk ka nevojë pala me u marrë me këto vendime të stërzgjatura. Komplet tokat përgjatë magjistrales nga Kaçaniku e deri në Gërlicë është tokë bujqësore, kështu që ne duhet t'ia hapim rrugët vetës për me trajtuar zhvillimin pak me ndryshe.

znj. Ardita Rrahmani: Vlerësimi i komisionit është së, kësaj prone i ka humbur karakteri bujqësor, për shkak të ndërtimit të autostradës. A duhet me pasur komision për hartimin e PZHK ?

Kryesuesi i Kuvendit: PZHK është duke u hartuar, por është vonuar bukur shumë.

z. Agim Mani: Nëse e kemi PZHK, është lehtë, së plani zhvillimor ta mundëson një trajtim të tillë të çështjeve, por çështja është se nuk kemi PZHK, se atij plani i ka skaduar afati. Planet zhvillimore e kanë afatin edhe 2 vite pasi t'i skadon afati.

Kryesuesi i Kuvendit: PZHK e kemi, plani është në fuqi. Afati i PZHK është 8 vjet. Sipas ligjeve në fuqi PZHK para 8 viteve as nuk guxon të prekët, pas 8 viteve kemi të drejtë me ndryshuar planin zhvillimor, por mundemi edhe mos me ndryshuar. PZHK duhet të ndryshohet, se ai plan nuk i plotëson kushtet dhe kriteret.

z. Agim Mani: Derisa nuk e kemi PZHK, ne po na bien barra si KK me vendosur. Unë për atë kërkesë sqarim më në detaje, përndryshe lë të merret ekzekutivi i komunës me ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, por nuk po e merret se po frikësohet, e po ia adresoni KK.

Kryesuesi i Kuvendit: Vendimi është marrë nga komisioni, vendimi është me nënshkrim e vulë, por komisioni nuk ka kompetencë me marrë vendimin e fundit. Komisioni për këtë vendim ka

përgjegjësi penale nëse ka dhënë vlerësim të gabuar, se e shqyrton dikush ligjshmërinë e atij vlerësimi.

z. Agim Mani: Atëherë kryetari i komunës ta merr vendimin vet për ndërrim destinimi të tokave bujqësore.

Kryesuesi i Kuvendit: Kryetari nuk ka të drejtë me marrë vendim, se me pasur të drejtë nuk na e kishte sjell neve këtu. Vendimin e merr KK dhe vendimet e KK i nënshtrohen shqyrtimit të ligjshmërisë, ndërkaq me marrë vendim kryetari apo komisioni, vendimet e tyre nuk shkojnë në shqyrtim të ligjshmërisë, kjo është arsyeja pse duhet vendosë KK këto çështje. Nëse vendimi është në harmoni me ligjin, shkohet tutje, nëse nuk është në harmoni me ligjin, atëherë KK e shfuqizon vendimin e vet. KK nuk është ekspert i fushës dhe mundet me gabuar, ekspert të fushave janë komisionet, komisionet munden me u penalizuar për vlerësime të gabuara.

z. Agim Mani: Për me hequr barrën prej veti, ekzekutivi na i adreson neve këto çështje. Ndërrimi i destinimit të tokës bujqësore nga 1-4 klasë vendosë KK, me pëlqim të ministrisë.

Kryesuesi i Kuvendit: Ndërrimin e destinimit të tokave bujqësore prej 1-4 klasë është vendim paraprak, këto vendime shkojnë në ministri dhe pasi të merr miratimin nga ministria i kthehen KK për vendim përfundimtar. Atëherë meqë nuk ka diskutime të tjera nuk ka, atëherë e shtroj në votim për aprovim Propozim Vendimin e kësaj pike, i njëjti u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së KPF e,

Aprovoj

Propozim Vendimi për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, PK 01402-1 ZK Soponicë, me kulturë Bujqësore Arë e Klasës së 5, me sipërfaqen 3917m², pronë e Ekrem (Ramadan) Hyseni nga Ferizaj, nën qiramarrje 99 vjet. Të njëjtin ia

Rekomandon

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

8. Propozim Vendimi për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, PK 00311-0 ZK Ivajë, me kulturë Bujqësore Livadh i Klasës së 6, në sipërfaqen 300m², pronë e Samedin (Vehbi) Rexha nga Kaçaniku;

Kryesuesi i Kuvendit: Materialin e keni marrë, ne mund të diskutojmë sa të doni, por janë tema të njëjtës natyrë. Vlerësimi i komisionit iu është bashkëngjitur lëndës. Nëse ka kush diçka, e hapi diskutimin:

z. Agim Mani: Sipas ligjit, neni i cili e rregullon këtë çështje, ndërrimi i përhershëm i tokës bujqësore në tokë ndërtimore të klasës 1-4, do të bëhet me vendim të KK, pas marrjes së pëlqimit nga ministria.

Kryesuesi i Kuvendit: Po, për vendime paraprak, zakonisht ne i trajtojmë vendimet paraprake, e ndërkaq vendimi përfundimtar merret pas pëlqimit nga ministria. Vendimet paraprake janë bërë, për shkak se palët nuk kanë pasur mundësi me dërguar lëndën në ministri, tani i dërgon komuna vendimet e KK, ndërsa pas pëlqimit të ministrisë, komuna merr vendimin përfundimtar.

z. Qamil Stagnova: Unë kam pasur takime me zyrtarë të ministrisë, ata thonë se nuk bëjmë ndërrime të destinimeve. Për atë arsye ata kërkojnë se, a është paraparë me PZHK dhe ndonjë vendim që komuna pajtohet me ia ndërruar destinimin e asaj prone. Unë do t'iu informoj se për çështjen e vendimeve paraprake. a janë të obliguara me ardhur përsëri në KK apo i vendos ministria.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, atëherë e shtroj në votim për aprovim propozim vendimin e kësaj pike dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF e

Aprovoj

Propozim Vendimi për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, PK 00311-0 ZK Ivajë, me kulturë Bujqësore Livadh i Klasës së 6, në sipërfaqen 300m², pronë e Samedin (Vehbi) Rexha nga Kaçaniku. Të njëjtin ia

Rekomandon

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

9. Propozim Vendimi për emërimin e komisionit përzgjedhës për drejtor të institucioneve arsimore;

Kryesuesi i Kuvendit: Edhe në vitin e kaluar kemi marrë vendime të kësaj natyre, komisioni formohet për udhëheqjen e procedurave për zgjedhjen e drejtorëve të shkollave. Drejtori nuk është këtu, nëse ka kush diçka e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë e shtroj në votim për aprovim propozim vendimin e kësaj pike dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF e ,

Aprovoj

Propozim Vendimin për emërimin e komisionit përzgjedhës për drejtor të institucioneve arsimore. Të njëjtin ia

Rekomandon

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

10. Propozim Vendimi për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore PK 01123-6 ZK Kaçanik i Vjetër, me kulturë bujqësore Arë e Klasës 6, me sipërfaqe 600 m², pronë e KBI;

Kryesuesi i Kuvendit: Nëse ka kush me diskutuar, e hapi diskutimin:

z. Agim Mani: Të kjo pikë, kjo pronë sigurisht së është e BI, ndërkaq me intereson a ka filluar ndërtimi i xhamisë apo jo ?

z. Qamil Stagnova: Ndërtimi i xhamisë nuk ka filluar.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, atëherë e shtroj në votim për aprovim Propozim Vendimin e kësaj pike, i njëjti u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF e,

Aprovoj

Propozim Vendimin për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore PK 01123-6 ZK Kaçanik i Vjetër, me kulturë bujqësore Arë e Klasës 6, me sipërfaqe 600 m², pronë e KBI. Të njëjtin ia

Rekomandon

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

11. Propozim Vendimi për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore PK 0001952-0 ZK Kaçanik, me kulturë bujqësore Arë e Klasës 6, me sipërfaqe 600 m², pronë e KBI;

Kryesuesi i Kuvendit: Nëse ka kush me diskutuar, e hapi diskutimin:

znj. Kadriije Lika-Troni: Të kjo pikë, a është prona të xhamia në Dushkajë ? Xhamia është ndërtuar, ndërkaq nuk janë marrë veprimet paraprake para se me u ndërtuar xhamia.

z. Qamil Stagova: Leje ndërtimi nuk ka, ata tani janë paraqitur me i zhvilluar procedurat e nevojshme.

znj. Kadrije Lika-Troni: A i shikon komuna këto punë se a kanë leje ndërtimi apo jo këto objekte që po ndërtohen? Si po shihet, po na përcjell kjo çështja e ndërtimit të objekteve, pa i marrë veprimet paraprake.

Kryesuesi i Kuvendit: BI është subjekt juridik, ndoshta nuk është shumë problematike, më problematike është për ndërtuesit privat të cilët ndërtojnë, pastaj kërkojnë leje ndërtimi.

z. Agim Mani: Çështja e ndërtimit të xhamisë pa leje ndërtimore është me e ndjeshme, sepse nuk mundesh me ia prishur as me PZHK, se janë objekte të mbrojtura, ndërkaq edhe pse është xhami, është BI ajo që e ka shkelë ligjin, ndërkaq ligji vlen për të gjithë njësoj.

Kryesuesi i Kuvendit: Nuk e ka shkelur ligjin, por janë vonuar procedurat. Çka po thoni ju me bërë në këtë drejtim?

znj. Kadrije Lika-Troni: Ne po e japim si vërejtje se po bëhen ndërtimet, pa i ndjekur procedurat e nevojshme paraprake.

znj. Ardita Rrahmani; Pavarësisht faktit se a është xhami, nuk jemi kundër ndërtimeve të objekteve fetare, të paktën inspektorët me qenë pak më në nivel me i kryer punët e veta.

z. Agim Mani: Ne, nuk jemi me prishur objektin xhami, por çështja është se, ku ka qenë komuna para 2 viteve, ku janë drejtorët dhe inspektorët të cilët marrin paga, për atë edhe paguhen, sepse duhet arsyetuar pagat e tyre ?

z. Sabedin Vishi: Ne po e pranojmë se është bërë lëshim ndërtimi i këtij objekti pa leje ndërtimi, nuk jemi duke i mbrojtur ndërtimet pa leje.

z. Qamil Stagova: Unë nuk po dua me i mbrojtur inspektorët, por ndoshta me vet faktin se po ndërtohet objekt xhami, janë ndier keq me marrë veprime të nevojshme.

znj. Ardita Rrahmani: Ne duhet me qenë të vetëdijshëm se ligji vlen njëjtë edhe për kishë edhe për xhami, edhe për inspektorin edhe për persona fizik edhe për subjektin juridik.

Kryesuesi i Kuvendit: Unë në aspektin ligjor nuk po themi së është mirë, por në aspektin moral, organizohen komunitetet me ndërtuar një xhami, moralisht ndoshta nuk duhet me i trajtuar njëjtë personat juridik.

znj. Ardita Rrahmani: Çka nëse kishim pasur në Kaçanik edhe komunitete të feve tjera, dhe diku ndërtohet një kishë, diku një xhami, a llogariten këto uzurpime ? Ne jemi të vetëdijshëm se nuk ka uzurpim këtu, po shkelje është bërë, se kryesuesi po e përmend se është xhami e nuk ka lidhje, por çka nëse është ndërtuar kishë, e i pengon dikujt tjetër? Ne po flasim për gabimin që është bërë, po flasim për një problem i cili ka ndodhur para 2 viteve, e cila çështje është dashur me kaluar përmes procedurës së KPF dhe KK. Për mos me ndodhur këto, të paktën inspektorët me i arsyetuar pagat e tyre, me dalë ndonjë herë në terren me shikuar gjendjen e ndërtimeve pa leje.

z. Qamil Stagova: Uzurpim nuk është, por shkelje ligjore ka.

z. Kadri Krivenjeva: Po të nisemi ashtu siç thoni ju, apo siç kërkohet, të jenë të bindur se edhe shtëpitë tona apo ndonjë objekt tjetër ndoshta i kemi pa legalizuar. Në shumicën e rasteve ndoshta

edhe inspektori apo kushdo tjetër, duhet me i mbyllur sytë dashtë e pa dashtë, edhe pse është joligjore- jo në rregull një ndërtim i tillë. Ne po merremi me një xhami e cila është duke u ndërtuar, ndërkaq mund të ketë edhe objekte tjera pa legalizim.

znj. Ardita Rrahmani: Ndërtimi i objekteve pa leje ndërtimi nuk arsyetohen. Ne nuk jemi kundër ndërtimit të xhamisë, së është shumë e nevojshme, por ne po flasim për procedurat të cilat duhet me u zhvilluar, pavarësisht objektit që ndërtohet, qoftë kishë apo xhami.

z. Kadri Krivenjeva: Edhe unë pajtohem që zyrtarët kompetent me qanë me striktë, me i përcjellë gjendjen në terren të ndërtimeve pa leje.

z. Sabedin Vishi: Se pari BI nuk është dashur me e nisur fare objektin xhami pa u bërë ndërrimi i destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, por ka ndodhur ndërtimi dhe kjo çështje ka ndodhur dhe nuk mundemi ta lëmë ashtu si është, por duhet rregulluar.

Kryesuesi i Kuvendit: Pasi u ndërtua objekti, kjo është çështje e ndishme, se qysh me ia prishur objektin xhami, ndërkaq fillimisht me pas ardhur të BI ia kishim treguar procedurat për me ardhur deri të ndërtimi i objektit. Ne po e kuptojmë gabimin që është bërë, po mendojmë se duhet me kaluar, se nuk mund ta lëmë pa e rregulluar. Diskutime të tjera nuk ka, atëherë e shtroj në votim për aprovim propozim vendimin e kësaj pike dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së KPF e

Aprovoj

Propozim Vendimin për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore PK 0001952-0 ZK Kaçanik, me kulturë bujqësore Arë e Klasës 6, me sipërfaqe 600 m², pronë e KBI. Të njëjtin ia

Rekomandon

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

12. Propozim Vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik për këmbim të pronës komunale me pronën private ZK Begracë, 17 parcela të evidentuara në emër të N.P.P.T.T.SH. ALK-OIL me nr. të biznesit 70052105;

Kryesuesi i Kuvendit: Para se me hapur diskutimin, fjalën e ka drejtori i DUKMM, Qamil Stagova me na sqaruar këtë çështje.

z. Qamil Stagova: Prona është në afërsi të stacionit të trenit në Gërlicë, është një rrugë e cila në shumicën e rasteve shfrytëzohet vetëm nga kompania, mirëpo ata e kanë një kërkesë që rruga që kalon përmes kësaj ndërmarrje me u larguar nga aty dhe me u shfrytëzuar rruga të pjesa ku lëshohet një pjesë për rrugën që ekziston të stacioni i trenit dhe anash përskaq parcele prapë lidhet me rrugën ekzistuese edhe një rrugë tjetër malore kalon nëpër parcelë edhe ajo me shkuar nëpër skajin e pronës së kësaj kompanie. Mendoj së propozimi është i mirë, për shkak së me ekzistuar një rrugë nëpërmes kompanive që janë paksa të rrezikshme nuk është mirë. Kompania e ka bërë ndoshta për interesa të veta, por propozimi nuk është i keq, për arsye se kompania ushtron një veprimtari të rrezikshme të llojit të veçantë.

z. Agim Mani: Rruga e cila i ndan bizneset përmes, a ka qasje në pronat e tjera, kjo rrugë a i lidhë pronat tjera ? Nëse kjo rrugë i mbyllë qasjen e parcelave tjera, a ka marrë ndërmarrja pëlqim nga pronarët e atyre parcelave ?

z. Qamil Stagova: Rruga nuk mbyllet, vetëm ç vendoset di kah tjetër. Kur është hapur ndërmarrja, rrugën e ka hapur si rrugë të re. Rruga lidhet me rrugën Gërlaç-Viti. Parcelat janë krejt të ndërmarrjes, nuk ka aty prona të tjetërkujt.

Kryesuesi i Kuvendit: Se pari duhet ditur kjo rrugë, a është në kadastër.

z. Qamil Stagova: Sqaroj me skemë se ku gjendet rruga, dhe projektimi i ç vendosjes së saj.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, atëherë e shtroj në votim për aprovim propozim vendimin e kësaj pike dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF e

Aprovoj

Propozim Vendimin për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik për këmbim të pronës komunale me pronën private ZK Begracë, 17 parcela të evidentuara në emër të N.P.P.T.T.SH. ALK-OIL me nr. të biznesit 70052105. Të njëjtin ia

Rekomandon

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

Diçka tjetër për këtë takim nuk ka, kështu e konstatoj mbledhjen e përfunduar në ora: 12:6. Deri në fund të mbledhjes qëndruan të gjithë anëtarët e KPF. Mbledhja e Kuvendit do të mbahet me 29 Prill 2022 në ora 11:00.

Procesmbajtës
Makfire Malsiu

Makfire Malsiu

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Murseli

